



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 365

Ora: 10:30

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 31 MARS – 6 PRILL 2023**

Sot, më datë 15.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Banka e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Prefekti i Qarkut Berat, Bashkia Kamëz.

OBJEKTI: Vlerësimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 31 mars deri më 6 prill 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Në përfundim të këtij shqyrtimi

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 31 mars deri më 6 prill 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 262 aktivitete nga 67 Institucione raportuese. Nga verifikimi

Data: 15.4.2023 Nr. 365
Ora:10:30



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 31 mars – 6 prill 2023”

paraprak rezulton se, nga këto, 11 aktivitete të zhvilluara nga 8 institucione, janë raportuar në tejkallim të afatit ligjor. Nga këto veprimtari, të raportuara jashtë afatit ligjor/me pjesëmarrje personash politik, është ndaluar 1 veprimtari publike, e planifikuar për t'u zhvilluar nga Bashkia Korçë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim të gjitha rastet e raportuara në shkelje të afatit të raportimit si vijon:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor, të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktiviteti “Ftesë për pjesëmarrje në forumin me titull: Standarte për Turizëm Cilësor dhe të Qendrueshëm, raportuar më datë 5.4.2023 për t'u zhvilluar më datë 6.4.2023
 - Aktiviteti “Ftesë për pjesëmarrje në forumin me titull: Standarte për Turizëm Cilësor dhe të Qendrueshëm”, raportuar më datë 5.4.2023 për t'u zhvilluar më datë 8.4.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nuk ka patur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktiviteti “Vënia e gurrthemelit të Korridorit 8”, raportuar më datë 31.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 4.4.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, nuk ka patur mundësi faktike për raportim brenda afatit ligjor, pasi konsiderohet që është një veprimtari që nuk është organizuar nga ky institucion, por ka patur pjesëmarrjen e Ministrit të Shtetit për marrëdhëniet me Parlamentin, si pjesë e delegacionit zyrtar, takim i zhvilluar në Tetovë, Maqedoni.

3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Pjesëmarrje në ceremoninë për nisjen e punimeve të Korridorit të 8 në Tetovë”, raportuar më datë 31.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 4.4.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, nga hetimi i kryer dhe nga të dhënat e raportuara në ndërfaqen e KQZ-së, vlerëson se aktiviteti i raportuar konsiderohet që është një veprimtari që nuk është organizuar nga ky institucion, por ka patur pjesëmarrjen e Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, si pjesë e delegacionit zyrtar, takim i zhvilluar në Tetovë, Maqedoni. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

4. Banka e Shqipërisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Aktivitet i Akademisë së Shkencave, nderim i figurës së Aristotel Panos, ora 11.00, fjalim i Guvernatorit”, raportuar më datë 31.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 4.4.2023
- Aktiviteti “Intervistë e Guvernatorit për Revistën Monitor” raportuar më datë 31.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 3.4.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson në lidhje me aktivitetin e parë se, është një veprimtari e organizuar nga Akademia e Shkencave për të nderuar figurën e Aristotel Pano-s, ku Guvernatori i Bankës së Shqipërisë është në cilësinë e të ftuarit. Në këto kushte nuk ka detyrim për raportim.

Në lidhje me aktivitetin e dytë, gjatë, vlerësohet se nuk është aktivitet i organizuar, nga Banka e Shqipërisë, për të cilin ka detyrim për raportim.

5. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Riinspektim i Bashkive”, raportuar më datë 31.3.2023 për tu zhvilluar në datë 5.3.2023
- Aktiviteti “Riinspektim i Bashkive”, raportuar më datë 31.3.2023 për tu zhvilluar në datë 6.3.2023

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nëpërmjet email-it të datës 13.4.2023, ka paraqitur pretendimet e veta në lidhje me shkeljet e konstatuara dhe ka sqaruar se: *Në vijim të emailit tuaj, lidhur me raportim e dy aktiviteteve ju bëj me dije se, gjatë procesit të raportimit të këtyre*

aktiviteteve në faqen www.aktivitete.kqz.gov.al ka ndodhur një gabim, në të cilën është vendosur 03 (muaji Mars), kur bëhet fjalë për raportimin e aktiviteteve në muajin Prill (04).

Aktivitetet janë zhvilluar si më poshtë vijon:

Aktiviteti “Bashkitë përkatëse janë inspektuar gjatë muajit shkurt 2023 dhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, masa për to është “Paralajmërim”, për rrjedhojë është përcaktuar që do të riinspektohen”, me datë zhvillimi 5.4.2023.

Aktiviteti “Bashkitë përkatëse janë inspektuar gjatë muajit shkurt 2023 dhe në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, masa për to është “Paralajmërim”, për rrjedhojë është përcaktuar që do të riinspektohen”, me datë zhvillimi 6.4.2023.

Për sa më sipër, lutemi marrjen në konsideratë nga ana juaj faktin që ka ndodhur një gabim njerëzor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se aktiviteti i raportuara me vonesë ka ardhur si pasojë e një gabimi të kryer gjatë raportimit. Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga problematikat e raportimit në ndërfaqe, vlerëson se aktiviteti i raportuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nuk përbën kundërvajtje administrative.

6. Prefekti i Qarkut Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktivitet “Takimi i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit”, raportuar në datë 3.4.2023 dhe datë zhvillimi 6.4.2023.

Prefekti i Qarkut Berat, nëpërmjet emailit të datës 11.4.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: “Ky aktivitet është i karakterit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhri e Kryeministrit, nr. 20, datë 1.3.2023 “Për ngritjen e task-forcës ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2023” (bashkëlidhur kësaj shkrese) dhe Urdhri e Prefektit të Qarkut Berat, nr. 33, datë 29.3.2023 “Për miratimin e planit të masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2023 si dhe ngritjen e task-forcës për Qarkun Berat (bashkëlidhur kësaj shkrese). Për kryerjen e këtij aktiviteti Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat (sektori I MKVFD) i ka njoftuar pjesëmarrësit më datë 31.3.2023 dhe në të njejtën datë Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e personit përgjegjës për raportimin, ka filluar procedurat në ndërfaqe, për publikimin e këtij takimi. Në pritje të konfirmimit për pjesëmarrje të përfaqësuesit të Ministrisë së Mjedisit në këtë takim, raportimi përfundoi më datë 3.4.2023 (bashkëngjitur printimi i emailit). Ky aktivitet (i karakterit jo publik) nuk është pasqyruar në faqe interneti, media, rrjete sociale apo në asnjë nga format e përcaktuara në pikën 2 të Kujtesës mbi “Veprimtarinë e Institucioneve Publike”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se aktiviteti i organizuar nga Prefekti i Qarkut Berat, është një veprimtari e karakterit

administrativ institucional, me pjesëmarrjen e gjerë, të disa institucioneve, të cilat duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre, bazuar dhe në urdhrin nr. 20 datë 1.3.2023, të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, “Për ngritjen e task-forcës ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2023”. Përsa më sipër, nuk është mundur të respektohet afati ligjor i raportimit.

7. Bashkia Kamëz ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Mbledhja e rradhës e Komitetit Antikanabis”, raportuar më datën 31.3.2023 për t’u zhvilluar më datën 6.3.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se aktiviteti i raportuara me vonesë ka ardhur si pasojë e një gabimi të kryer gjatë raportimit. Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga problematikat e raportimit në ndërfaqe, vlerëson se aktiviteti i raportuar nga Bashkisë Kamëz, nuk përbën kundërvajtje administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,
 - b) Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin,
 - c) Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,
 - ç) Banka e Shqipërisë,
 - d) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile,
 - dh) Prefekti i Qarkut Berat,
 - e) Bashkia Kamëz

- 2) Ky vendim t'u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
- 3) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 4) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI